

Në bazë të nenit 20 dhe nenit 25 të Ligjit për shërbim gjyqësor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 43/14, 98/15, 06/16, 198/18 dhe 248/18) dhe nenit 2 të Rregullores për formën dhe përmbajtjen e shpalljes publike, formën, përmbajtjen dhe mënyrën e parashtrimit të fletëparaqitjes, të realizimit të përzgjedhjes administrative, të provimeve, kontrollimit të besueshmërisë së dëshmimeve dhe intervistës si dhe mënyrën e vlerësimit të tyre dhe numrit maksimal të pikëve nga procedura e përzgjedhjes varësisht nga kategoritë e vendeve të punës si dhe çështje të tjera në lidhje me procedurën për punësim të nëpunësve gjyqësor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " numër 236/18), Rregullores për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë dhe pëlqimit nga Ministria e financave nr. 18 – 8025/2 e datës 16.10.2019

## GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

### Publikon

### SHPLLJE PUBLIKE NUMËR 1/2019

për punësim të 12 (dymbëdhjetë) nëpunësve gjyqësor për kohë të pacaktuar, për vendet e punës :

#### 1. Kategoria V, niveli V1

##### **Këshilltar gjyqësor – 5 realizues**

Kushtet për kryerje të punëve:

Të arritura 300 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1, të mbaruar fakultetin juridik me provim të dhënë të jurisprudencës dhe së paku 3 vjet përvojë pune në profesion

Neto shuma e pagesës në të holla: 28.582,00 denarë

#### 2. Kategoria V, niveli V2

##### **Bashkëpunëtor i lartë gjyqësor – 4 realizues**

Kushtet për kryerje të punëve:

Të arritura 300 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1, të mbaruar fakultetin juridik me provim të dhënë të jurisprudencës dhe së paku 2 vjet përvojë pune në profesion

Neto shuma e pagesës në të holla: 26.571,00 denarë

#### 3. Kategorija G, niveli G1,

##### **Referent i lartë gjyqësor - daktilografi - 2 realizues**

Kushtet për kryerje të punëve:

Së paku arsim të lartë ose të mesëm dhe së paku 2 vjet përvojë pune, në profesion

Neto shuma e pagesës në të holla: 18.157,00

- Certifikatë të mjekut për gjendjen e përgjithshme shëndetësore

- Certifikatë ose vërtetim me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerjen e profesinoit, veprimtarisë ose detyrës

- Diplomë, certifikatë ose vërtetim si dëshmi për njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë

- Kandidatët për nëpunës gjyqësor në procedurën për punësim përmes shpalljes publike, njohjen aktive të një prej tri gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) do ta dëshmojnë përmes dhënies së provimit për nëpunës gjyqësor – pjesa për kontrollim të diturisë të një prej tri gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Fetëparaqitja, krahas dëshmimeve, është e obligueshme të përmbajë: emër dhe mbiemër të kandidatit të mbështetura me dëshmi për identifikim personal, vendbanim gjegjësisht vendqëndrim të kandidatit, e-mail adresë ose kontakt telefon.

Afati për paraqitjen e fletëparaqitjes është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit të shpalljes në gazetata ditore (duke mos llogaritur ditën e vet publikimit)

#### 4. Kategorija G, niveli G4

##### **Referent i ri gjyqësor – realizues në shkresore – 1 realizues**

Kushtet për kryerje të punëve:

Së paku arsim të lartë ose të mesëm me ose pa përvojë pune

Neto shuma e pagesës në të holla: 15.988,00

Kompetencat e posaçme të punës për vendet e punës 1, 2, 3 dhe 4: Njohje aktive e një prej tri gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht), njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe kompetenca të tjera të posaçme të punës të përcaktuara në aktin për sistematizim të vendeve të punës për vendin përkatës të punës.

Të gjithë kandidatët për vendet e punës 1, 2, 3, dhe 4, krahas kushteve të theksuara të posaçme, të parapara në Regulloren për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, kandidatët për vendet e theksuara të punës duhet të përmbushin edhe kushtet e përgjithshme që parashihen në nenin 21 paragrafi 1 të Ligjit për shërbim gjyqësor:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- në mënyrë aktive të njëj gjuhën maqedonase,
- të jetë i moshës së madhore,
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerjen e profesinoit, veprimtarisë ose detyrës.

Për të gjitha vendet e punës :

Orari javor i punës 40 orë;

Orari ditor i punës 8 orë, prej orës 7:30 deri në ora 15:30;

Kandidatët e interesuar, obligohen që të parashtrajnë fletëparaqitje të plotësuar për punësim të nëpunësit gjyqësor (formulari të publikuar në Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr.236/18) me dëshmitë për plotësim të kushteve të përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës në të cilin paraqiten në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter:

- Certifikatë për arsimin e kryer përkatës
- Dëshmi për përvojë pune
- Certifikatë të shtetësisë

Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet të përmbushin në momentin e paraqitjes.

**Vërejtje:** Kandidati i cili do të parashtrijë të dhëna jo të sakta do të diskualifikohet nga procedura e mëtejshme.

**Vërejtje:** Koha dhe data e mbajtjes së përzgjedhjes administrative, provimi dhe intervista publikohen në ueb faqen e Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut ( [www.vsrn.mk](http://www.vsrn.mk))

Fletëparaqitjet e dorëzuara pas afatit, jo plotësisht të plotësuara, të pa rregulluara dhe të pa kompletuara, nuk do të shqyrtohen.

Fletëparaqitjen me dëshmitë, kandidatët obligohen që ta parashtrijnë drejtpërdrejtë në departamentin për pranim të dokumenteve në Gjykatë, gjatë orarit të punës ose përmes adresës postare:

#### **Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut**

**Bul. Krste Misirkov pn. Shkup**

**(me shenjë për Shpallje publike numër – 1/19)**

Procedura për përzgjedhje dhe punësim do të realizohet sipas Rregullores për formën dhe përmbajtjen e shpalljes publike, formën, përmbajtjen dhe mënyrën e parashtrimit të fletëparaqitjes, të realizimit të përzgjedhjes administrative, të provimeve, kontrollimit të besueshmërisë së dëshmimeve dhe intervistës si dhe mënyrën e vlerësimit të tyre dhe numrit maksimal të pikëve nga procedura e përzgjedhjes varësisht nga kategoritë e vendeve të punës si dhe çështje të tjera në lidhje me procedurën për punësim të nëpunësve gjyqësor (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë ” numër 236/18)

Kandidatët që do të kalojnë përzgjedhjen administrative japin provimin me shkrim në lokalet e Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Baza e pyetjeve për dhënien e provimit me shkrim, literatura e nevojshme, si dhe fletëparaqitja për nëpunësit gjyqësorë është në ueb faqen me qasje publike në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut ([www.vsrn.mk](http://www.vsrn.mk))